



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:296121
Datë: 12.04.2022
Numri i dokumentit: 02908094
C.nr.01/2022

GJYKATA THEMELORE GJILAN-, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares Florije Qerimi, me bashkëpunorin profesional Baki Sylejmani në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.R. nga fshati P., K. e Gj., të cilën me autorizim e përfaqëson, A. L.i avokat në Gjilan, ndaj të paditurës D.e P. e P. së Kosovës me adresë në Prishtinë, Rr”Luan Haradninaj”, pa nr. me objekt kontesti anulim i vendimit dhe kthim në vendin e punës, jashtë seance, më datë 05.04.2022 mori këtë :

A K T V E N D I M

I.HEDHET poshtë si e pa afatshme padia e paditësit B. R. nga fshati P., Komuna e Gj., e parashtruar ndaj të paditurës D. e P. e P. së Kosovës në P., për anulimin e vendimit dhe kthim në vendin e punës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi B.R. nga fshati P. Komuna e Gj, përmes të autorizaurit të tij, av.A.L., pranë kësaj gjykate me dt. 24.12.2021, ka paraqitur padi ndaj të paditurës D. e P. e P. së Kosovës, me objekt kontesti: anulim i vendimit dhe kthim në vendin e punës. Mes tjerash paditësi në petitumin e padisë kërkon që të anulohet si kundërligjshëm Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës Nr.....KBD/21 i datës2022 si dhe vednimi i Komisionit të Policiës për Ankesa, Nr.i lëndës-KA-2021 i dt.....2021 dhe të detyrohet e paditura D. e P. e P. së Kosovës me adresë në Prishtinë, që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës si Zyrtar në Stacionin e Policisë në Gj., me kompensimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës. Pos tjerash, paditësi i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak duke u kujdesur për rregullësinë e padisë dhe detyrës zyrtare sa i përket afatit për paraqitjen e padisë në gjykata, gjeti se padia e paditësit është parashtruar jashtë afatit ligjor, pasi që paditësi padinë e ka parashtruar në gjykatë më datën 24.12.2021.

Paditësi i pakënaqur me Vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor nr.....KBD/21 të datës2021, ka paraqitur ankesë të e paditura, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe masës disiplinore, ndërprerja e marrëdhënies së punës me porpozim që Komisioni i Ankesave ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar dhe ta anulojë vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Komisioni i ankesave i Policisë së Kosovës më datën e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga paditësi B. R. dhe ka lënë në fuqi Vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor nr...../KBD/21 të datës, lidhur me masën e shqiptuar disiplinore “Ndërprerja e marrëdhënies së Punës”.

Me dispozitat e Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, përkatësisht me dispozitën e nenit 78 të këtij ligji parashihet: *“I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”*. Dhe në dispozitën e nenit 79 të po këtij ligji parashihet: *“ Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditëve, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente ”*. Ndërsa me dispozitën e nenit 391 pika (f) e LPK-së parashihet se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:.... (pika f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”*, në rastin konkret afati për paraqitjen e padise ka qene i përcaktuar me dispozita materiale, konkretisht me nenin 79 të Ligjit të Punës.

Gjykata deri te ky konstatim erdhi duke u bazuar në shkresat e lëndës, sipas të cilave rezultoi se paditësi fillimisht si palë e pakënaqur me vendimin e komisionit të brendshëm disiplinor të dt....., ka ushtruar ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale, sipas të cilës ankesë, e paditura ka vendosur duke e refuzuar të njëjtën dhe duke e lënë në fuqi Vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor lidhur me masën e shqiptuar disiplinore “Ndërprerja e marrëdhënies së punës”, por që e njëjta është dashur që brenda afatit prej 15 ditësh pas heshtjes administrative të të paditurës të paraqesë padi, ku këtë paditësi nuk e kishte bërë në afatin e paraparë ligjor, por që këtë e ka bërë me datë2021, do të thotë se të njëjtën e ka ushtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

Gjykata vlerëson se paditësi ka pasur të drejtë ligjore që në mënyrë të lirshme të ushtrojë mjetet juridike në rrugë gjyqësore, mirëpo përdorimi i këtyre mjeteve juridike është dashur të bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat e neneve 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Andaj, mos shfrytëzimi i këtyre mjeteve juridike brenda afateve të caktuara (afate prekluzive), ka si pasojë edhe humbjen e të drejtës për mbrojtje gjyqësore, dhe jo për shkak se kjo e drejtë i është mohuar paditësit, por për shkak se ky i fundit ka dështuar që me kohë t'i shfrytëzojë këto mjete juridike të cilat i ka pasur në dispozicion. Paditësi në rastin konkret ka humbur të drejtën

në mbrojtje gjyqësore pasi që padinë e ka parashtruar jashtë afatit ligjor nga shkaqet e lartëcekura, andaj gjykata ka vendosur në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Pnës lidhur me nenin 391 pika f) të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendim.

Gjykata Themelore Gjilan -Departamenti I Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.01/2022, më datë 05.04.2022

Gjyqtarja
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.